VENDIM
Nr.91, datë 26.9.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERALD ENERGJITIK" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET "SHEMRI" DHE "MGULLE"

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9, 13 pika 1 germa "a" dhe 15 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "a", 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Erald Energjitik" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Erald Energjitik" sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me lejet nga institucionet e tjera (pika e lidhjes nga rrjeti i shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5), rezulton në proces realizimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Erald Energjitik" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: "Shemri" me fuqi 1 MW dhe "Mgulle" me fuqi 0.28 MW, për një afat 30-vjeçar, me kusht që:
   - Shoqëria "Erald Energjitik" të dorëzojë "Miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes", brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licencës.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani